



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ prot.

Shkodër, më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: INVESTIME NE KUADER TE PROJEKTIT” BASHKI TE
ZGJUARA ENERGJIE”(Rruga Gjylbegaj)**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: **Kodi CPV:
45231400-9 - Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike, 45233140-2 - Punime rrugore,
45315100-9 - Instalime inxhinerike elektrike,**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,200,831 (tre milion e dyqindmije e tetëqind e tridhjetë e një)
lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar:

Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **1,280,332 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar “Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kërkesa qe garantojme qe operatorët ekonomikë kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar për te zbatuar kontraten”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për te permbushur me sukses kontraten.

Duke marre ne konsiderate vlerën e fondit limit të kesaj procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te këtë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,280,332 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh**, vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për **vitin 2025 (sipas QKB) si dhe kestet e maturuara per vitin 2026** sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.2.2, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 5/ c), nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **960,249 (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e nëntë) lekë** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **3,200,831 (tre milion e dyqindmijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë**.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.
- c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë **të deklaruar në fazën e tenderimit.**
- d) Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4: *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ...Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:*

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këto mënyra, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), Udhezimi i K.M nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vlerësimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor, elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi ne toke”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge, autostrada, mbikalime...”

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime per N/Stacionet kabinat e transformatoreve..”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve ...”

Kategoria NS-4 Niveli A “Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to...”

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, 'Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi', i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Punimet në preventiv, zeri nr 13	Niveli A	187,900 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge, autostrada ,mbikalime....	Punimet në preventive, zeri nr 12,18,19,20,21,22	Niveli A	750,970 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime për N/Stacionet, linja të tensionit të lartë dhe të mesëm...	Punimet në preventiv, zeri nr 1,2,3,4,7,8,9,10,11	Niveli A	1,876,295 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime për prishjen e ndertimeve	Punimet në preventiv, zeri nr 6,14,16,17	Niveli A	153,214 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-4</u>	Punime rifiniture të muratës...	Punimet në preventiv, zeri nr 5	Niveli A	77,337 leke pa tvsh

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt të paktën:

1(nje)inxhinier ndertimi
1(nje) inxhinier elektrik

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat përkatëse E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar

kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

- **Inxhinieri elektrik** është përgjegjës për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen si dhe kategorive perkatese ne licencen perkatese te zbatimit.

-**Inxhinieri ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt .

2.3.4 Vetdeklarimin nga inxhinieri ndertimit,elektrik se ata jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020”Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier elektrik dhe të deklaroje se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ne nenin 39, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet te jetë **6 (gjashtë)**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjesve **6 (gjashte)**

Afati 42 dite kalendarike (6 jave) .

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $1468:6:40=6.11$ puntore.

Nevojiten:

1- Puntore rrugor nevojitet per kryerjen e punimeve te ndertimit te shtresave rrugore ne objekt

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: **$474:6:40=1.97$ puntore.**

2- Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit si ndertim struktura te ndryshme betoni dhe shtrese pllakash ne trotuare .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte **$479:6:40=1.99$ muratore.**

3-Elektriciisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: **$521:6:40=2.17$ puntore.**

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), ose te kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate apo ne rastin kur makinerite jane me qera per manovratoret, me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

Murator	1 (nje) punonjës
Elektriciist	1 (nje) punonjes
Shofer	1 (nje) punonjes
Manovrator	1 (nje) punonjes
Puntor rrugor	2 (dy) punonjes

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe (Automaknist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmë nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

1- Puntore rrugor nevojitet për kryerjen e punimeve të ndërtimit të shtresave rrugore në objekt. Sasia e orëve të punës sipas manualit është **474:6:40=1.97 puntore.**

2- Muratori nevojitet për kryerjen e punimeve të ndryshme të ndërtimit si ndërtim struktural të ndryshme betoni dhe shtrese pllakash në trotuare. Sasia e orëve të punës sipas manualit është **479:6:40=1.99 muratore.**

3-Elektriçisti nevojitet për kryerjen e punimeve elektrike në objekt. Sasia e orëve të punës sipas manualit është: **521:6:40=2.17 puntore.**

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe vëllimet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jete me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar. Kërkesa për deshmitë e manovratorëve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
----	--------	-------

1	Mjet transporti veteshkarkues mbi 7 ton (kapac.mbajtes)	1 copë
2	Mjet transporti me ngarkese mbi 1.5 tone	1 copë
3	Autovinc me kosh me kapacitet 2.5 ton	1 copë
4	Matrapik	1 copë
5	Betoniere	1 copë
6	Prerese asfalti	1 cope
8	Aparate Luxmeter per fluksin e ndricimit	1 cope
9	Minifadrome	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata **përkatëse e qirasë** ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

-Mjeti i transportit me ngarkesë mbi 7 ton, vetshkarkues nevojitet për transportin e materialeve të ndërtimit si dhëra, inerte, binder dhe A/B dhe shtylla ndriçimi.

-Mjeti i transportit me ngarkesë mbi 1.5 ton nevojitet për transportin e materialeve sipas zerave të preventivit si cemento materiale elektrike.

-Autovinci me kosh nevojitet për çmontimin e shtyllave ekzistuese dhe vendosjen e kraheve të ndricuesve sipas zerave të preventivit.

-Matrapiku nevojitet për prishjen e trotuarit ekzistues sipas zerave të preventivit.

-Betoniera nevojitet për prodhimin e llaceve dhe betoneve sipas zerave të preventivit..

-Prerese asfalti nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit.

-Minifadroma nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit.

Mjet transporti vetshkarkues mbi 7 ton (ngarkesa)

Transport dhëra $132 \text{ m}^3 \cdot 1.6 = 212 \text{ ton}$

Transport inerte $9.24 \text{ m}^3 \cdot 1.8 = 16.64 \text{ ton}$

Transport A/B+Binder – 1.45 ton

Transport materiale të ndryshme -2 ton

Totali 232 ton : 30=7.74 ton ,mesatarisht 1-2 rruge në ditë.

Periudha e garancise për defektet është 2 vjet pas marrjes në dorezim të objektit (hartimit të procesverbalit të marrjes në dorezim dhe certifikates)

Është vendosur ky kriter duke u bazuar në ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar pasi periudha e garancise së punimeve referuar këtij ligji shkon nga 1 deri 2 vite

2.3.9 Ofertuesi pjesëmarrës në tender duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për materialet e mëposhtme në mënyrë që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në specifikimet teknike.

1. Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi/akt-marreveshje lidhur me Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët

ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkojnë në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

2. Katalogun/et ose skedat teknike për të gjitha mallrat e kërkuara, të cilat duhet të përputhen me përshkrimin e bere në specifikimet teknike dhe certifikatë/deklaratë konfirmimit CE. Në rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Ndricues LED 40W, 3000K, 5500 lm	copë	1
2	Kuader komandimi	copë	1
3	Kabell 3x1.5 mm ²	ml	1
4	Kabell 4x6 mm ²	ml	1
5	Percjelles tokezimi bakri S=35mm ²	ml	1
6	Krah shtylle 1 koke, harkor Ø70 me diameter 300 cm dhe lartesi h 150 cm prej celiku te zinkuar	copë	1

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Sipas materialit bashkëngjitur DST.

Informacion për ofertuesit: Kjo kontratë bashkëfinancohet nga SECO dhe MIE bazuar në Marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran “Për Bashkëpunimin teknik,financiar dhe humanitar” te lidhur ne daten 11.05.2007 dhe e ratifikuar me Ligjin Nr 9801 datë 13.09.2007“, Marrëveshjen datë 12.11.2021 “Mbi dhenien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e “Projektit të Bashkive me Energji Inteligjente”(SEMP),të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Konfederatës Zvicerane, Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Shkoder dhe Sekretariatit të Shteti Zviceran për Çështjet ekonomike (SECO)